

VENDIM
Nr. 461, datë 3.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 560, DATË 29.9.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR ÇAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E
OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pikat 2 e 3, 10 dhe 101, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 9, 10, pika 7, dhe 13, shkronja "c", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e aneksit 1, bashkëlidhur vendimit nr. 560, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
 2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama